

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (Seancë e hapur)

Faqe 1

1 E enjte, 31 mars 2022

2 [Seancë e hapur]

3 [I akuzuarit hyn në sallën e gjyqit]

4 --- Seanca fillon në orën 9.30

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

6 Mirëmëngjes.

7 Z. Sekretar i seancës, ju lutem paraqitni lëndën.

8 SEKRETARI I SEANCËS: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar
9 Gjykatës. Kjo është çështja KSC-BC-2020-05, Prokurori i
10 Specializuar kundër Salih Mustafës.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

12 Faleminderit.

13 Të shohim të pranishmit.

14 Znj. Prokurore, e keni ju fjalën.

15 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar
16 Gjykatës. Faleminderit. Zyra e Prokurorit të Specializuar sot
17 përfaqësohet nga Prokurori i Asociuar, Filippo De Minicis;
18 Menaxheri i Çështjes, Julie Mann; dhe unë, Prokurore e
19 Asociuar, Silvia D'Ascoli.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

21 Faleminderit.

22 Fjala për ju, Avokate e Viktimave.

23 ZNJ. VOSSSENBERG: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar
24 Gjykatës. Ne sot përfaqësohemi nga Rozy [Sipas përkthimit]
25 Vossenberq, që jam bashkëavokate.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (Seancë e hapur)

Faqe 2

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

2 Faleminderit.

3 Avokati Mbrojtës, fjala për juve.

4 Z. VON BONE: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar Gjykatës.

5 Mbrojtja përfaqësohet nga Betim Shala, bashkëmbrojtës;

6 përkthyes dhe hetues, z. Fatmir Pelaj; dhe unë, Julius Von

7 Bone.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë

9 mirë.

10 Për procesverbal jemi përpara Trupit Gjykes numër I.

11 Sot do të vazhdojmë me dëshminë e Dëshmitarit 500, z.

12 Borovci.

13 Znj. Sekretare, ju lutem, a mund ta sillni dëshmitarin në

14 sallë.

15 [Dëshmitari vijon dëshminë]

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

17 Borovci, mirëmëngjesi. Mirë se u kthyet në Dhomat e

18 Specializuara të Kosovës. A më dëgjoni?

19 DËSHMITARI: Po. Mirëmëngjes, për ju dhe për të gjithë të

20 pranishmit në sallë.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

22 Faleminderit. A patët kohë të pushonit?

23 DËSHMITARI: Po. Mirë. Falemnders.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

25 Borovci, ju kujtoj që jeni ende nën betim dhe keni detyrimin

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Hazir Borovci (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje vijuese nga z. Von Bone

Faqe 3

1 që të tregoni të vërtetën. Tani do të vazhdojmë me pyetjet nga
2 Prokuroria.

3 Znj. Prokurore, fjala për ju.

4 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Shumë faleminderit, të nderuar
5 Gjykatës. Unë rishikova atë çfarë ne bëmë dje dhe çfarë u tha
6 dje dhe për momentin nuk kemi pyetje të tjera për z. Borovci.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
8 Faleminderit, znj. Prokurore.

9 Avokati i Mbrojtjes, dje na thatë - jo. Avokatja e
10 Viktimave, ju thatë dje që nuk keni pyetje për këtë dëshmitar.
11 E saktë është kjo?

12 ZNJ. VOSENBERG: [Përkthim] Po.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë
14 atëherë.

15 Avokat Mbrojtës, doni që të vazhdoni me pyetjet
16 plotësuese të dëshmitarit?

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju
18 lutem, mikrofonin.

19 Z. VON BONE: [Përkthim] Po, e nderuar Gjykatëse. Kemi
20 disa pyetje.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë
22 mirë. Ju lutem, vazhdoni

23 DËSHMITARI: HAZIR BOROVZI [Vijon]

24 Pyetje vijuese nga z. Von Bone:

25 Py. Mirëmëngjes.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Hazir Borovci (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje vijuese nga z. Von Bone

Faqe 4

1 Pë. Mirëmëngjes.

2 Py. z. Dëshmitar, dje ju treguan disa fotografi të tuajat të
3 cilat i keni postuar në Facebook. Dhe në një prej fotografive,
4 ishte postimi i z. Ibrahim Mehmetaj, i cili njihet ndryshe si
5 Bimi për ne.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Keni
7 ndonjë referencë në transkript?

8 Z. VON BONE: [Përkthim] Po. Kam referencën për postimin
9 në Facebook që është referenca 0032571. Dhe referenca në
10 transkript është në faqen 79.

11 Py. Këtu juve ju bë një pyetje:

12 "Dhe ju na thatë që ju dhe z. Mehmetaj jeni shok" ishte
13 pyetja. Dhe përgjigja ishte:

14 "Po".

15 Kjo është thënë në faqen 79 rreshti, rreshti 15, 16.

16 Tani, fakti që ju jeni shok me z. Mehmetaj, z. Borovci, a
17 përbën ndonjë ndryshim për dëshminë që ju keni dhënë përpara
18 Gjykatës dje dhe sot?

19 Pë. Atë që e kam thënë dje, e them edhe sot. E kam pasë shok
20 edhe fqinj me të. Jemi rrit bashkë. Jemi afër.

21 Py. Po. Po pyetja ime është, a sjell ndonjë ndryshim fakti që
22 ju e keni shok atë, domethënë, dëshmisë që keni dhënë këtu në
23 Gjykatë lidhur me vendndodhjen tuaj apo gjëra të tjera të
24 cilat ju i keni thënë përpara Gjykatës, sjell ndonjë ndryshim
25 ky fakt?

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Hazir Borovci (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje vijuese nga z. Von Bone

Faqe 5

1 Pë. Nuk sjell ndryshim se e kam shok dhe fqinj, do të thotë,
2 kurrëgjë s'ndryshon.

3 Py. Në rregull. A keni diskutuar me z. Mehmetaj ndonjë gjë që
4 ju keni dëshmuar këtu përpara Gjykatës?

5 Pë. Për Gjykatën nuk kemi diskutuar, por kemi diskutuar
6 çështje politike, për shkak se unë jam veprimtar i LDK-së, ai
7 është veprimtar i një subjekti të AAK-së. Dhe kemi biseduar
8 për çështje me të cilat mirremi si subjekte do të thotë dhe
9 rrimë, takohemi. Jemi afër fqinjë, kojshi. Jemi shok, miq.
10 Jemi rrit bashkë.

11 Py. Në rregull. Shumë faleminderit. A të ka pyetur ty ndonjë
12 person tjetër ndonjëherë që të thuash diçka që do të ishte në
13 favor të z. Mustafaj? A të ka thënë ty, të ka kërkuar ndonjë
14 njeri që të thuash një gjë të tillë përpara Gjykatës?

15 Pë. Jo.

16 Py. Në dëshminë që keni dhënë, në këtë dëshmi, pra, a keni
17 thënë të vërtetën?

18 Pë. Të vërtetën e kam thënë para jush, në deklaratë edhe dje
19 edhe sot. Të vërtetën si atëherë, si sot.

20 Py. Në rregull. Dje, z. Borovci, Prokuroria ju pyeti rreth
21 datës së mbërritjes tuaj në Butovc. Kjo është në faqen 83, në
22 rreshtat nga 23 deri në 25.

23 Unë nuk dua t'i futem sërish atij diskutimi, por dua të
24 di një gjë rreth jush apo më mirë rreth kohës kur ju keni qenë
25 në Butovc. Në kohën kur keni qenë në Butovc, kjo ishte koha e

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Hazir Borovci (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje vijuese nga z. Von Bone

Faqe 6

1 festës myslimane të Bajramit?

2 Pë. Po. Ishte 31 deri më 12 qershor, kur hynë forcat

3 paqeruajtëse në Prishtinë dhe anembanë Kosovës.

4 Py. Në rregull. Siç e thashë, unë nuk jam i interesuar për

5 data por jam i interesuar për festën myslimane. A e mbani mend

6 se në çfarë rrethanash është festuar kjo festë myslimane, nuk

7 e di në qoftë se mund të përdor termin festoj?

8 Pë. Po. Në shenjë të respektit të festës së myslimanëve, të

9 festës së Bajramit edhe atëherë edhe dje edhe sot e kam

10 përdorë fjalën "festë". Po në rrethana çfarë ka jetuar

11 popullata civile, çfarë ka jetuar populli, nuk kemi mujt edhe

12 dje e thashë, nuk kemi mujt të festojmë. Po kanë bë Bajram,

13 është bë Bajram mes veti.

14 Po festa, të festojmë si është në traditën e myslimanëve

15 nuk ka pasë mundësi, se s'ka pasë kushte as për përgatitje, as

16 kushtet elementare s'kanë qenë, po Bajram është bë. Është

17 respektue festa. Dhe rrethanat e ndodhjes, do të thotë, kanë

18 qenë shumë të rënda. Këtë e thashë edhe dje edhe sot. Do të

19 thotë, se nuk ka ekzistue dhe s'është pritur. Unë s'e kam

20 pritë, as nuk e kemi pritë prej një regjimi serb që ta

21 respekton festën. Ai s'e ka respektu jetën e njerëzve, jetën e

22 civilëve, e po respekton festën e Bajramit.

23 Jam mundue të jam i saktë dhe të dhashë sa mundem për

24 periudhën në të cilën kam folë dje dhe e thashë edhe sot.

25 Py. Shumë faleminderit. Z. Borovci, a keni pasur ju

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Hazir Borovci (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje vijuese nga z. Von Bone

Faqe 7

1 ndonjëherë informacion të lidhur me deklaratën që ka dhënë z.
2 Mustafa, deklaratën dhe intervistimin nga ZPS-ja? Dje juve ju
3 tregua një fragment i deklaratës por pyetja ime është më e
4 përgjithshme. Domethënë për çdo lloj deklarate që ai ka dhënë
5 për ZPS-në, a e keni pasur ju idenë se çfarë është thënë në
6 ato deklarata?

7 Pë. Duhet të jem prapë edhe këtu i saktë. Do të thotë, nuk
8 jam marrë shumë me deklarata. Do të thotë, ajo ishte risi. Do
9 të thotë, për herë të parë që e pashë këtu, e lexova edhe me
10 përjashtim përmes mediave që jemi informu përmes mediave,
11 portaleve, do të thotë, nuk kam pasë -- për shkak se edhe
12 ndoshta edhe duke qenë i bindur në pafajësinë dhe në
13 pastërtinë e Salih Mustafës edhe duke menduar se Aktakuza që
14 është ngri mbi ta në fund -- po.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
16 Dëshmitar, ju lutem jepini përgjigje pyetjes.

17 Z. VON BONE: [Përkthim]

18 Py. Unë mendoj që i jeni përgjigjur pyetjes, z. Dëshmitar. Sa
19 për ta sqaruar, ju lutem, a mund të thoni po apo jo. Pra, a
20 keni pasur dijeni për deklaratat që ka dhënë z. Mustafa për
21 Zyrën e Prokurorisë?

22 Pë. Vetëm përmes portaleve, gazetave. Dhe faqes të juve, do të
23 thotë, çka jipen përmes gazetave. Jo, tjetër s'kam pasë asnjë
24 informacion tjetër. Prej askujt. Vetëm përmes portaleve,
25 përmes gazetave, përmes mediave elektronike.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Hazir Borovci (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje vijuese nga z. Von Bone

Faqe 8

1 Py. Çfarë doja t'ju thosha ishte që dje juve ju tregua një
2 dokument. A ishte hera e parë që ju e patë atë dokument dje?

3 Pë. Ishte hera --

4 Py. E kam fjalën për dokumentin që ju tregoi Prokurorja.

5 Deklaratën që ishte një pjesë apo një fragment i deklaratës së
6 dhënë nga z. Mustafa.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E
8 keni referencën, Avokat?

9 Z. VON BONE: [Përkthim] Po mundohem të gjej referencën.
10 Referenca për ju, të nderuar Gjykatës, është --

11 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, në qoftë
12 se mund t'ju ndihmoj?

13 Z. VON BONE: [Përkthim] Mendoj se fillon --

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Kam
15 dhe unë referencën këtu.

16 Z. VON BONE: [Përkthim] Mendoj që fillon në faqen 97. Kur
17 është treguar dokumenti në ekran. Pra, është dokumenti 069404-
18 TR-ET. Në faqen 97 të transkriptit të djeshëm, në rreshtin 23
19 dhe 25.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
21 Faleminderit, Avokat. Kjo ishte dhe referenca që kishim ne.

22 Z. VON BONE: [Përkthim]

23 Py. Pra, pyetja ime është kjo: A ishte hera e parë që ti e ke
24 parë këtë dokument në jetën tënde?

25 Pë. Hera e parë që e pashë dje.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Hazir Borovci (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje vijuese nga z. Von Bone

Faqe 9

1 Py. Shumë faleminderit. A e dini ju se cili ka qenë konteksti
2 në të cilin është dhënë deklarata në dokumentin që ju tregua
3 juve, domethënë, në çfarë konteksti e ka dhënë z. Mustafa
4 deklaratën që ju patë? E dini këtë gjë?

5 Pë. Nuk e di.

6 Py. Në rregull. A mund ta dini ju në qoftë se këto deklarata
7 kanë qenë të sakta apo jo?

8 Pë. Kisha rezervë, për shkak se dy javët e para të prillit,
9 do të thotë, gjegjësisht, fillimi dhe orientimisht mund të mos
10 jem i saktë tash një ditë dy. Po ashtu, do të thotë, si e kam
11 thënë, do të thotë, unë kam pasë rastin ta takoj edhe tri-
12 katër herë pas datës 2 dhe 3. Do të thotë, ishte rasti i parë
13 që e pashë atë në ekran. Për këtë arsye, do të thotë, nuk
14 kisha njohuri. S'e kam dëgjuar. S'e kam parë as në media, as
15 në portale. Hera e parë këtu që e pashë.

16 Py. Në rregull. Çfarë ju thatë këtu, përpara Trupit Gjykses,
17 lidhur me kohën në të cilën e keni takuar atë në Butovc, a
18 është e saktë ajo çfarë keni deklaruar; a është e saktë?

19 Pë. Mund të më shpëton për shkak të kujtesës, të largësisë,
20 por ndryshe kur e thomi një çështje, nuk e harroj lehtë. Do të
21 thotë, kështu e kam thënë unë në deklaratë te ju, kështu e
22 thashë dje nën betim, po dhe sot nën betim e them po të
23 njëjtën. Do të thotë, e saktë ashtu si e kam thënë unë.

24 Py. Shumë faleminderit. A mundet të konsultohem pak një
25 moment?

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Hazir Borovci (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje vijuese nga z. Von Bone

Faqe 10

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

2 Avokat, një koment prej meje. Në rreshtin 17, faqja 8, ju
3 thoni:

4 "Ajo çfarë keni thënë para Gjykatës lidhur me kohën kur
5 ju e keni parë atë në Butovc, a ishte e saktë ajo çfarë keni
6 thënë, çfarë keni deklaruar?"

7 Ka pasur disa pyetje lidhur me datat. Dhe mendoj që kjo
8 është një pyetje shumë e përgjithshme që përfshin shumë gjëra
9 dhe gjithashtu edhe pyetje të cilat janë bërë lidhur me datat
10 që ai nënkuptonte apo periudhat kohore. Pra, mendoj që kjo
11 është një pyetje shumë e gjerë. Dhe mbase është me vend që të
12 specifikohet në këtë kontekst.

13 Z. VON BONE: [Përkthim] E nderuar Gjykatëse, nuk e shoh
14 arsyen pse duhet të specifikohet më tepër kjo pyetje, sepse
15 unë fillova më parë me faktin që unë nuk isha i interesuar për
16 datën, por isha i interesuar për ngjarjet e ndodhura dhe këtë
17 doja të sqaroja përmes dëshmitarit.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Kjo
19 ju takon juve, po thjesht domethënë doja t'jua sillja në
20 vëmendje që kjo është një pyetje shumë e përgjithshme. Ja u lë
21 ju në dorë në qoftë se nuk doni që pyesni detaje të tjera
22 lidhur me të.

23 Z. VON BONE: [Përkthim] Dua të konsultoj diçka, e nderuar
24 Gjykatëse.

25 [Përfaqësuesit e Mbrojtjes këshillohen]

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Hazir Borovci (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga Trupi Gjykses

Faqe 11

1 Z. VON BONE: [Përkthim] Faleminderit shumë, të nderuar
2 Gjykatës. Nuk kemi pyetje të tjera. Faleminderit edhe
3 dëshmitarit.

4 Py. Faleminderit për dëshminë e dhënë në Gjykatë edhe
5 faleminderit për kohën.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
7 Faleminderit, Avokat.

8 Tani i drejtohem ZPS-së. A keni pyetje plotësuese për
9 këtë dëshmitar?

10 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Jo, e nderuar Gjykatëse. Nuk
11 kemi pyetje të tjera.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë
13 mirë.

14 Avokatja e Viktimave, keni pyetje për dëshmitarin?

15 ZNJ. VOSENBERG: [Përkthim] Jo, nuk kemi.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Kemi
17 mbërritur në fazën tjetër.

18 Z. Borovci, ju janë bërë shumë pyetje nga palët dhe do
19 t'ju kërkoja që të na duroni dhe pak sepse Trupi Gjykses
20 dëshiron t'ju bëjë gjithashtu disa pyetje në mënyrë që të
21 marrë ca sqarime lidhur me dëshminë e dhënë në Gjykatë dhe
22 deklaratat e dhëna më parë.

23 Tani do t'i jap fjalën kolegut në të majtën time për të
24 bërë pyetjet e më tejshme.

25 Pyetje nga Trupi Gjykses:

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Hazir Borovci (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga Trupi Gjykses

Faqe 12

1 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Faleminderit, znj.

2 Kryegjykatëse.

3 Kam disa pyetje për ju, z. Borovci, do t'i referohem
4 deklaratës së dhënë më 31 mars 2021, dokumenti DSM00572. Në
5 faqen 3 të deklaratës që keni dhënë për Avokatin e Mbrojtjes.
6 Dhe do të citoj tek ajo çfarë keni thënë:

7 "Ne vijmë tani më 28 mars 1999. Kjo ishte koha, pra, këto
8 ditë edhe ditët më përpara dhe unë do t'ju tregoj se çfarë kam
9 dëgjuar me veshë dhe çfarë kam parë me sytë e mi. Më 28 mars,
10 forcat paramilitare erdhën nga tri drejtime të ndryshme".

11 Në të njëjtën faqe thoni:

12 "Që të gjitha shtëpitë në Prishtinë u braktisën. Kështu
13 që më 28 mars 1999, neve u vendosëm në disa shtëpi të
14 pabanueshme dhe në stalla. Disa prej nesh u vendosëm në
15 shtëpinë e profesor Mustafës".

16 Pra, në të njëjtën faqe juve e përsërisni tre herë dhe
17 dukeni sikur jeni shumë të sigurt për datën 28 mars. A mund të
18 na e shpjegoni, ju lutem, që pse ishit kaq i sigurt në atëkohë
19 rreth kësaj date?

20 Pë. Atë që e thashë dje prapë -- isha i sigurt duke e
21 ndërlidhë me festën e Bajramit të vogël. Asgjë nuk ka ndryshu.
22 Krejt ato çka i kam thënë, e paralajmërova dje që vetëm
23 zhvendoset 28 me 31. Do të thotë, deri më 31 kemi qëndruar
24 aty. Po duke menduar unë, se më 28 më ka koencidu me festën e
25 Bajramit dhe e kam thënë më 28. Më 31 jemi zhvendos nga pjesa

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Hazir Borovci (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga Trupi Gjykses

Faqe 13

1 ku kemi veprue në Velani. Kurse më 28, 29, 30 ka pasë
2 zhvendosje nga pjesë tjera të Prishtinës. Data 31 ka qenë datë
3 ku jemi zhvendosur të gjithë, jo me dëshirë, po ashtu si e kam
4 thënë dje.

5 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Në rregull. Pra, megjithëse,
6 megjithatë, në atë kohë, juve nuk ju referuat fare, nuk e
7 përmendët fare festën myslimane në mënyrë që të vendosnit
8 datën 28?

9 Pë. Unë besoj që e kam përmend festën myslimane. Është në
10 material të Avokatit.

11 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Nuk është. Jo në atë faqe kur
12 ju përmendni tre herë datën 28 mars. Nuk është as në faqen më
13 pas që është faqja DSM00573.

14 E di çfarë do të thuash, Avokat i Mbrojtjes.

15 Dhe në faqen tjetër ju thoni:

16 "Dhe këtu ju mbërritët më datë 28 mars?"

17 Dhe ju thoni:

18 "Po. Dhe aty qëndruam në atë pjesë"

19 Në fakt, ju në faqen DSM00575 thoni:

20 "Kur mbërritëm në 28 mars në Butovc, nuk e takuam atë
21 atje. E njihnim atë nga më përpara. Megjithatë, në atë
22 periudhë, ne këtë e quanim Bajrami ose festa e Bajramit të
23 vogël. Dhe me shumë gjasa, ne jemi dëbuar në atë kohë".

24 Po e kuptoj që ju shtuat që disa ditë pas kësaj feste
25 Salih Mustafa erdhi te profesori. Kështu që ishte menjëherë më

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Hazir Borovci (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga Trupi Gjykses

Faqe 14

1 pas mund të ketë qenë data 2 ose 3 prill, ose java e parë e
2 prillit.

3 Thjesht vras mendjen, që ju gjatë gjithë kohës i
4 referoheni datës 28, megjithatë, domethënë, ju e keni dhënë
5 një shpjegim, kështu që nuk do të insistoj lidhur me këtë.

6 Tani më lejoni t'i kthehem deklaratës që keni dhënë dje,
7 faqja 17, rreshti 2 deri në 7, ku deklaroni si më poshtë.

8 Pyetje:

9 "Kur jeni larguar faktikisht? Kur ka ndodhur? Sa pas
10 sulmeve ajrore të NATO-s ka ndodhur kjo? E mbani mend datën?

11 Përgjigja është:

12 "Po, e mbaj mend datën. Ka qenë në fund të marsit. Në
13 fakt, në deklaratën time unë kam thënë 28 mars. Po përderisa
14 jam nën betim, ne nuk jemi larguar më 28 mars, po në fund të
15 marsit. Pra, më 31 mars, ne ishim të detyruar të largoheshim
16 nga Prishtina".

17 Kam një pyetje këtu. Pse i referoheni deklaratës së
18 mëparshme, ndërkohë që kjo deklaratë në atë kohë nuk ju është
19 vënë në dispozicion nga Mbrojtja, nga Avokati i Mbrojtjes, nuk
20 u përmend nga Avokati i Mbrojtjes.

21 Pë. Në vetëm e përshkruaj gjendjen, rrethanat në të cilat
22 jemi zhvendos edhe arsyen pse dhe qëllimin pse. Edhe e dha
23 edhe datën, do të thotë, ashtu saktë si e thatë ju. Do të
24 thotë, e përshkruajë gjendjen, rrethanat, situatat, çka na ka
25 shtyrë dhe si ka ardhë deri te zhvendosja në fund të marsit,

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Hazir Borovci (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga Trupi Gjykses

Faqe 15

1 gjetësisht, 31 mars.

2 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] E kuptoj këtë. Por pse në atë
3 çast të caktuar në përgjigje të pyetjes që ju bë nga Avokati
4 juve i referoheni deklaratës së dhënë më parë?

5 Pë. Unë edhe njëherë, do të thotë, i referohem datës 31, për
6 shkak se 24 mars, data e granatimeve dhe deri më 31, çdo ditë
7 ka ngjarje të rëndësishme në Prishtinë. Nuk ka ditë që nuk ka
8 pasë ngjarje për të përkujtue, për t'ju përmend juve, po unë
9 jam fokusue në ngjarjet kryesore do të thotë.

10 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Pyetja ime e dytë, lidhur me
11 atë çka keni thënë, është se ja keni shpjeguar avokatit, i
12 thoni kështu:

13 "Po meqenëse jam nën betim, nuk jemi largu më datë 28 por
14 në fund të marsit".

15 Pse bëni këtë lidhje midis faktit që ishit nën betim dhe
16 këtij ndryshimi nga 28 në 31? Mund ta shpjegoni këtë?

17 Pë. Po. E nderuara Gjykatë, këtu është sinqeriteti dhe
18 parimi, e drejta që unë e demonstroj. Unë, do të thotë,
19 tregoj, do të thotë, që jo më 28 po më 31 mars. Do të thotë,
20 për sinqeritet, për të drejtën, për të vërtetën do të thotë.
21 Asgjë, do të thotë, nuk ka të bën për të mshefur jo për jo
22 s'ka të bën asgjë. Vetëm çka e kthej kujtesën e ndodhisë e të
23 ngjarjes, do të thotë, jo me 28 po më 31 mars kur zhvendosmi
24 në fshatin Butovc. Besoj se jashtëzakonisht drejtë, në mënyrë
25 të drejtë dhe të saktë e kam argumentue, e kam spjegue, po

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Hazir Borovci (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga Trupi Gjykses

Faqe 16

1 nëse eventualisht ka paqartësi, lirisht më tregoni. Unë
2 bashkëbisedoj prapë, shqyrtojmë.

3 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Do t'i kthehem tani një pjese
4 tjetër të deklaratës që keni dhënë këtu dje. Faqja 23,
5 rreshtat 11 dhe 12. Këtu thoni.

6 "Por, më duket, se jemi takuar gjatë gjysmës së dytë të
7 prillit..."

8 Pastaj në faqen 24, në rreshtat 17, 18, ju përmendni një
9 takim ose disa takime, pra, takim/takime me Salih Mustafën
10 java e parë e prillit deri më datë 15, 16, 17 prill. Tani jeni
11 takuar midis javës së parë dhe 17 prillit apo në gjysmën e
12 dytë të prillit?

13 Pë. Nëse, e nderuara Gjykatë, është bë gabim në përkthim,
14 shikojeni. Unë jam i sigurt në atë që e kam thënë. Do të
15 thotë, më datën 2, gjegjësisht 3 ka qenë takimi i parë. Kurse
16 tri-katër herë, gjegjësisht pesë herë takime të tjera. Nuk i
17 kam thënë që jemi takue në pjesën e dytë. Po kam thënë kam
18 mund qëndron ka qenë aty dikun deri ka pjesa e dytë e muajit
19 prill gjegjësisht 15, 16 prilli. Kurse unë takimet e tjera që
20 i kam pasë unë me z. Salih Mustafa kanë qenë edhe tri-katër
21 takime tjera, të cilat nuk i kemi mbajtur çdo ditë, për shkak
22 se unë kam qëndruar te Reçicët. Ai ka qëndruar në familjen e
23 Sopit.

24 Vendi ku unë kam qenë i pozicionuar, do të thotë, në një
25 pikë jashtëzakonisht të rrezikshme dhe të ndijshme, unë kur e

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Hazir Borovci (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga Trupi Gjykses

Faqe 17

1 kam krye detyrën time, rojën time, jam kthye në familjen e
2 Reçicëve. Por ka pasë raste, kur jam kthye prej aty nëpër
3 oborrin, gjegjësisht nëpër shtëpinë e Mustafë Sopit;
4 gjegjësisht prindit të Mustafës, se kanë qenë disa shtëpia
5 aty, Smail Sopi.

6 Këtë e kam thënë dje dhe jam mundue ta shpjegoj nëse ka
7 pasë në përkthim ndonjë -- kjo është që e kam thënë dje edhe
8 po e them prapë sot, po e sqaroj, po e sforcoj, veçse ka
9 ndodhë ndonjë lëshim në përkthim.

10 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Në fakt në faqen 26, rreshtat
11 9 dhe 19 ju thatë që:

12 "...Mustafa qëndroi nëse -- pra, unë nuk e kam parë..."

13 Por, ju nuk e patë përditë. Kjo është e sigurt.

14 Faleminderit.

15 Pyetja tjetër: Në faqen 35 nga ajo që thatë dje, rreshtat
16 9 dhe 10, ju shpjeguat që mblidhnit informacione dhe ja
17 kalonit, ja jepnit Isa Kastratit. Dhe pastaj thatë që:

18 "...ata kishin linjën e tyre..."

19 Pra, kishte një linjë raportimi, një vijë raportimi,
20 brenda UÇK-së. E saktë?

21 Pë. Po, e saktë. Por prapë këtu ose nuk keni kërkuar përgjigje
22 ose në përkthim. Fillimisht ja kemi dhënë informacionet Isa
23 Kastratit - është fjala për periudhën 1998 - edhe Mustafë
24 Sopit. Por në vitin 1999, informacionet ja kemi dhënë Mustafë
25 Sopit. Do të thotë, unë personalisht i kam dhënë informacione

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Hazir Borovci (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga Trupi Gjykses

Faqe 18

1 edhe Isa Kastratit, se e kam pasë edhe kryetar të degës edhe
2 ja kam dhënë, unë kam qenë nënkryetar.

3 Kurse Mustafën e kam pasë një njohje shumë të hershme me
4 Mustafën. 40 vite jetë të përbashkët me të. E kam pasë
5 profesor edhe i kam besue. Edhe i ka pasë, njohjet, lidhjet
6 Mustafa i ka pasë me Salih Mustafën; kurse Isa ka pasë lidhje
7 me Zonën Operative të Llapit, ka pasë njohje ma të mira në ato
8 rrethana sesa unë dhe shokët tjerë. Këtë e kam thënë. Nëse
9 eventualisht, nuk është qartësuar ose s'është kuptue nga ana
10 juaj ndoshta -- ose s'e kam sqarue mirë unë ose përkthimi, po
11 kjo është që e ka thënë dje po e them prapë sot.

12 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Po. Unë mendoj se tani jeni
13 shumë më i qartë. Ju kishit dy linja raportimi. Njëra që
14 shkonte tek Salih Mustafa, tjetra që shkonte në Zonën
15 Operative të Llapit. Kështu po thoni?
16 Pë. Jo, i nderuar Gjykatës. Unë thashë në fillim të vitit --
17 gjatë vitit 1999, kemi informue, do të thotë, Isa Kastratin.
18 Po bëj përpjekje të jem ma i shkurtë, më i ngadalshëm. Kemi
19 informu edhe Mustafë Sopin. Që të dy. S'kanë qenë dy linja të
20 ndara. Se na kemi ndejtë bashkë edhe me Isën edhe me Mustafën.
21 Zakonisht në shtëpinë e Mustafës në shtëpia tjera, të
22 familjeve. Kurse më vonë informatat ja kam dorëzue, ja kemi
23 dhanë Mustafë Sopit për shkak se Isa ka kalue, nuk ka qenë
24 aty. Ka shku në zonën e Llapit.

25 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Po. Po Mustafë Sopi kujt i

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Hazir Borovci (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga Trupi Gjykses

Faqe 19

1 raportonte a e din?

2 Pë. Na nuk kemi ditur atëherë dhe dje e thashë, prapë po e
3 përsëris sot, nuk e kemi dit kuj i raporton as Isa, as
4 Mustafa. Po logjika, mendja na i ka marrë, që Isa ka lidhje me
5 Zonën Operative të Llapit se ka pasë njohje, ka pasë shok të
6 mahershëm që i ka mësue, që i ka pasë shokë të burgit. Kurse
7 Mustafa na ka tregue që Salih Mustafën e ka pasë nxënës. Na ka
8 tregue që me Salih Mustafa ka qenë në burg. Na ka tregue që
9 Salih Mustafa ka një familje të mirë.

10 Na ka tregue që Salih Mustafa, para se na me njoftë Salih
11 Mustafën, na tregonte kur rrinim në shtëpinë e Mustafë Sopit.
12 Na tregonte se është një patriot dhe në bazë të kësajna, na
13 nuk e pyetshmi për shkak se edhe me ruajtë Mustafën edhe ai me
14 na ruajte neve që në rast se biem -- do të thotë kjo.

15 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Në rregull. Faleminderit
16 shumë, z. Borovci. Faleminderit.

17 Unë nuk kam më pyetje të tjera, znj. Kryegjykatëse.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
19 Faleminderit.

20 Sa i takon pyetjes në transkript në faqen 23, rreshtat 11
21 deri në 12, do t'i kërkoj Njesisë së Shërbimeve Gjuhësore,
22 pra, nëse mund të rishikojmë përkthimin sa i takon frazës
23 "gjatë gjysmës së dytë të prillit" për të bërë krahasimet.

24 Atëherë me kaq, z. Borovci, kemi mbërritur kështu në fund
25 të dëshmisë suaj. Dëshiroj t'ju falënderoj për përpjekjet që

1 keni bërë për të dhënë dëshminë tuaj këtu, jam e sigurtë që do
2 të na ndihmojë në përpjekjet tona për të gjetur të vërtetën.
3 Ju falënderoj.

4 DËSHMITARI: Edhe juve, po ashtu edhe të gjithë stafit të
5 juj, ju falënderoj. Dhe kërkoj, Kryetare e Trupit Gjykues,
6 Shkëlqesia juaj, kërkoj prej jush jo mëshirë. Po kërkoj
7 drejtësi. Dhe jam shumë i bindur që do të vendosni drejtë, do
8 t'i analizoni mirë të gjithë dëshmitarët, mos bini pre e
9 dëshmitarëve të manipuluar, dëshmitarëve të shantazhuar, po
10 t'i analizoni mirë rrethanat në të cilat kemi veprue ,në
11 rrehanat në të cilat kemi punue, që kanë qenë rrethana tejet
12 të vështira. Dhe uroj që të mos t'i ndodhë asnjë populli,
13 asnjë kombi, ajo që na ka ndodhë neve.

14 Edhe njëherë, ju falënderoj juve dhe ju përsëndes të
15 gjithë ju që jeni këtu. Edhe e përsëndes edhe Salih Mustafën,
16 që unë e konsideroj të pafajshëm.

17 Faleminderit shumë, Shkëlqesia juaj, Kryetare e Trupit
18 Gjykues. Jemi mundue --

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po,
20 mjafton. Faleminderit. Ju dhashë hapësirë, z. Borovci, por mos
21 e kaloni cakun.

22 DËSHMITARI: Faleminderit.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju
24 uroj një udhëtim të mbarë për në shtëpi. Ju rikujtoj që të mos
25 ta diskutoni dëshminë që keni dhënë para Dhomave të

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (Seancë e hapur)

Faqe 21

1 Specializuara me askënd.

2 Znj. Asistente e sallës do t'ju shoqëroj tani që të dilni
3 nga salla.

4 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

6 Faleminderit, znj. Asistente e sallës.

7 Znj. Prokurore, ka diçka të cilën doni ta ngrini si
8 çështje në këtë moment?

9 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Asgjë, e nderuar Gjykatëse.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.

11 Mbrojtëse e Viktimave?

12 ZNJ.VOSSENBERG: [Përkthim] Asgjë, e nderuar Gjykatëse.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

14 Avokat i Mbrojtjes.

15 Z. VON BONE: [Përkthim] Asgjë, e nderuar Gjykatëse.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë

17 mirë. Në rregull atëherë.

18 Nëse nuk ka asgjë tjetër për të ngritur, qoftë edhe nga
19 ana tjetër e Trupit Gjykues, do të rifillojmë javën tjetër, më
20 datë 4 prill, në orën 9.30, me dëshminë e Dëshmitarit me numër
21 600.

22 Falënderoj palët. Falënderoj Mbrojtësen e Viktimave për
23 pjesëmarrjen. Dëshiroj të falënderoj përkthyesit, stenografët,
24 teknikët audiovizivë dhe personelin e sigurisë.

25 Këtu ndërpritet seanca.

1 --- Seanca përfundon në orën 10.13

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25